


# WOMentorship for Dialogue

[Mentorimi i grave për shkathtësi të dialogut]

» Shtator - Dhjetor 2019

Akademia e Dialogut e OSBE-së për projektin për gratë e reja\*



## Çka është programi

### WOMentorship për dialog?

*Alumnit e Akademisë së Dialogut të OSBE-së për Gratë e Reja janë bërë bashkë për t'i ndarë njohuritë dhe përvojat e tyre me gra të reja nga Prishtina dhe Beogradi, përmes programit WOMentorship për Dialog, ashtu që të bëhen faktorë të ndryshimit shoqëror në komunitetet e tyre dhe t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre profesionale dhe personale përmes programit të mentorimit në bazë të mësimnxënies mes bashkëmoshatarëve dhe dialogut.*

## Si funksionon?

Programi do të bëjë çift mentorin dhe të mentuarën nga Prishtina dhe Beogradi në bazë të interesave dhe shkathtësive të përbashkëta. Secili çift mentorimi do të ndjekë kornizën e përcaktuar individuale dhe kurrikulën për raportin e tyre të mentorimit, duke u mbështetur nga burimet që përqendrohen në barazi gjinore, udhëheqje, dialog dhe një grup të shkathtësive praktike që përzgjidhen nga mentorët. Të gjitha materialet do të jenë në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

## Kur dhe ku?

Programi do të fillojë në shtator, me takimin e parë mes mentorëve dhe të mentoruarave të paraparë që të mbahet prej 27-29 shtator në Nish. Takimet e drejtpërdrejta mes tyre do të mbahen nga muaji shtator deri në muajin nëntor përmes Skype ose personalisht, varësisht nga vendndodhja e çifteve të mentorimit. Takimi i dytë i të gjithë mentorëve dhe të mentoruarave do të mbahet në fund të dhjetorit në Prishtinë, me ç' rast do të paraqiten dhe rezultatet e programit.

## Kush mund të aplikojë?

Të drejtë aplikimi kanë nxënëset e shkollës së mesme të moshës 16-18 vjeç të cilat jetojnë në zonat që mbulohe nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Misioni i OSBE-së në Serbi.

## Si të aplikoni?


Kandidatat e interesuara duhet të plotësojnë aplikacionin në gjuhën angleze (shqipe/serbe) dhe ta dërgojnë atë në adresën e postës elektronike [dialogueacademy@osce.org](mailto:dialogueacademy@osce.org) deri më 13 shtator 2019. Formulari i aplikimit mund të gjendet në ueb faqen e Misionit të OSBE-së në Kosovë. Misioni i OSBE-së në Kosovë do t'i mbulojë të gjitha kostot e takimeve gjatë programit.

\*Akademia e Dialogut e OSBE-së për Gratë e Reja është akademi që zgjat 10 ditë e që organizohet për çdo vit që nga viti 2015 në kuadër të iniciativës "Follow Us", duke i bërë bashkë gratë e reja nga Prishtinë dhe Beogradi në lidhje me temat e dialogut, ndërtimit të besimit, udhëheqjes dhe fuqizimit të grave.

Ju lutemi dërgoni aplikacionin tuaj deri më 13 shtator 2019 (23:59)  
në [dialogueacademy@osce.org](mailto:dialogueacademy@osce.org).




Organization for Security and  
Co-operation in Europe



# WOMentorship for Dialogue

[Mentorimi i grave për shkathtësi të dialogut]



## Formulari për aplikim<sup>1</sup>

Emri dhe mbiemri:	
Data e lindjes:	
Data e lindjes:	
Komuniteti (opsionale):	
Shkolla e mesme:	
Klasa e shkollës së mesme <small>(duke filluar me vitin akademik 2019/20):</small>	
Posta elektronike:	
Numri i telefonit:	
Gjuha amtare:	
Tregoni se sa mirë e flisni gjuhën angleze:	<input type="checkbox"/> Rrjedhshëm <input type="checkbox"/> Mesatarisht <input type="checkbox"/> Nivel bazik <sup>2</sup>
Ju lutemi shkruani një paragraf të shkurtër mbi arsyen tuaj për të aplikuar në programin WOMentorship për Dialog dhe çfarë prisi të përfitoni nga ai?	
Anash e keni një listë të shkathtësive që mentorët tanë do t'i ndajnë me ju gjatë programit WOMentorship për Dialog.  Zgjidhni më së shumti 4 shkathtësi që ju interesojnë t'i përvetësoni:	<input type="checkbox"/> Rritja e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore; <input type="checkbox"/> Të folurit publik; <input type="checkbox"/> Bazat e punës kërkimore, analizimit dhe shkrimi i dokumenteve të politikave; <input type="checkbox"/> Bazat e menaxhimit i projektit; <input type="checkbox"/> Përdorimi i përgjegjshëm i mediave sociale dhe mendimi kritik; <input type="checkbox"/> Mendimi kritik dhe argumentimi; <input type="checkbox"/> Si të shkruani një CV dhe letër motivimi; <input type="checkbox"/> Përgatitja e artikujve gazetaresk; <input type="checkbox"/> Menaxhimi i kohës.

1 Ju informojmë se të dhënat nga ky formulari i aplikimit do të përpunohen vetëm për qëllime të procesit të përzgjedhjes për programin WOMentorship për Dialog.

2 Ju lutemi vëreni se niveli i njohurisë i gjuhës angleze do të merret parasysh gjatë procesit të krijimit të çifteve të mentorimit.